ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) – Divizioni i Ankesave- në përbërje te panelit shqyrtues: Vlora Rrustaj - kryesuese, Mevlyde Berisha dhe Xhevdet Neziri- anëtar, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit " ....." L.L.C., me NUI: ....., me seli të biznesit në Rr. ZSH Nr. -Prishtinë, kundër Këshillës/sqarimit/ përgjigjes profesionale me Nr. reference E------2025, në mbështetje të Nenit 111 të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa lejueshme ankesa me nr. ...../25 e datës 20.10.2025 e subjektit tatimor, ..., me NUI: ....., me seli të biznesit në: Rr.– Prishtinë, në mbështetje të Nenit 126, paragrafi 1, Neni 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Nenit 57 dhe 111 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, pasi që ankesa nuk është e drejtuar ndaj përcaktimit zyrtar nga ATK-ë.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesën me datë 20.10.2025 në Administratën Tatimore të Kosovës – Divizioni i Ankesave, e cila është pranuar me po të njëjtën ditë. Ndërkaq, këshillën/sqarimin/përgjigjen profesionale me nr. reference E..... 2025 e ka pranuar më datë .....2025. Si rrjedhojë, ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me nenin 111 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore.

Objekti i këshillës/sqarimit/përgjigjes profesionale me nr. reference E..... 2025, të lëshuar nga Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesve, ka qenë shqyrtimi i pyetjes së parashtruar nga tatimpaguesi "....." L.L.C., me NUI:....., më datë .....2025.

Ankesë- tatimpaguesi ne ankesën e tij tatimpaguesi e kundërshton përgjigjen/sqarimin me nr. reference E..... 2025 të lëshuar nga Divizioni për Përkrahje në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me datë .....2025 në depon e ankuesit shpërtheu një zjarr aksidental i cili i shkaktoj dëm të konsiderueshëm material në mallra të destinuara për shitje, asete të biznesit dhe ndërtesën e kompanisë. Të gjitha mallrat, asetet dhe ndërtesa ishin të siguruara nga Kompania e Sigurimit ....., me seli në ..... Me datë ..... zyrtaret e ATK-së vizituan subjektin ne vendin e aksidentit, dhe ne atë rast ankuesi i dorëzoj ATK-së një listë paraprake të mallrave, aseteve dhe ndërtesës se dëmtuar/shkatërruar nga zjarri. Gjatë vizitës zyrtaret e ATK-së e "njoftuan" ankuesin në mënyrë verbale se duhet të paguaj TVSH-

në dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave për kompensimin që ankuesi mund ta përfitoj nga Kompania e Sigurimit. Zyrtaret e ATK-së nuk ofruan asnjë bazë juridike në lidhje me ketë "njoftim". Duke marrë parasysh dhe me qellim të sqarimit të kësaj çështje dhe sigurimit të pajtueshmërisë se plotë të Ankuesit me ligjin ne fuqi , me datë ..... ankuesi kërkoj nga ATK nxjerrjen e një vendimi shpjegues individual ne lidhje më trajtimin e TVSH-së dhe TAK për mallrat, asetet dhe ndërtesën e dëmtuar/shkatërruar nga zjarri aksidental. Me kërkesën për vendim shpjegues individual, ankuesi kërkoj konfirmim se nuk do të kërkohet rregullim për TVSH-në e zbritur më parë për mallrat, asetet kapitale dhe ndërtesën e dëmtuar nga zjarri, në bazë të nenit 61 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar siç është ndryshuar dhe plotësuar (Udhëzimin Administrativ Nr.03/2015) si dhe kërkoj sqarim nëse kompensimi që ankuesi do ta përfitoj nga Kompania e Sigurimit për mallrat, asetet dhe ndërtesën e dëmtuar/shkatërruar nga zjarri, paraqet transaksion të tatueshëm për qëllime të TVSH-së. Ne lidhje me humbjet e shkaktuara nga zjarri, ankuesi kërkoj konfirmim nga ATK se shpenzimi i zbritshëm korrespondon me humbjen neto, përkatësisht vlerën totale të dëmit minus çdo kompensim të marrë nga Kompania e Sigurimit. Me datë ..... Divizioni për Përkrahje i Departamentit për Tatimpagues të Mëdhenj nxori Aktin e Kundërshtuar, në të cilin konstatoi se shuma e kompensimit që ankuesi do të pranoj nga Kompania e Sigurimit "konsiderohet e hyrë për qëllime tatimore" si për TAK, ashtu edhe për TVSH. Sipas ATK-së, vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse, e cila përcaktohet duke u llogaritur nga shuma e kompensimit në bazë të koeficientit të TVSH-së për normë standarde.

Këshillë/Sqarim/përgjigjeje: Me datë ..... me nr. protokolli 331/2025 dhe nr. reference E..... 2025 Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesve ka pranuar pyetjen/kërkesën nga "....." lidhur me korrigjimet për TVSH dhe TAK për mallrat dhe asetet e shkatërruara në një zjarr aksidental. Trajtimi i çështjes/pyetjes bazuar në analizën ligjore konkrete si vijim: neni 15, paragrafi 13, Vlerësimi i ATK për tatimin Ligji nr.08/L-257 13.*Për përcaktimin e detyrimeve tatimore, në rastin e prishjes, shkatërrimit ose djegies së mallit, për t'u pranuar si shpenzime të veprimtarisë ekonomike, mungesa e mallit dokumentohet nga tatimpaguesi me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente. Nëse sipas kërkesës së ATK, tatimpaguesi nuk dokumenton mungesën e mallrave, atëherë mallrat e tilla konsiderohen si mallra të shitura*., neni 41 Rregullimet e zbritjeve Ligji me nr.05/L-037, [...] 1. N*ë lidhje me mallrat kapitale, rregullimi duhet të kryhet gjatë pesë (5) viteve kalendarike. Për pasurinë e paluajtshme duhet të vlejë një periudhë njëzet (20) vite.3. Periudha korrigjuese që i referohet paragrafit 2 të këtij neni duhet të konsiderohet si pesë (5) vjet, duke filluar me/dhe përfshirë vitin në të cilin ka filluar shfrytëzimi i pajisjes. Në rast të pasurisë së paluajtshme njëzet (20) vite kalendarike duke filluar dhe përfshirë vitin kur ka filluar të shfrytëzohet objekti.3. Rregullimet vjetore duhet të bëhen vetëm në lidhje me një të pestën (1/5), respektivisht një të njëzetën (1/20) e TVSH-së së ngarkuar mbi mallrat kapitale. Ky rregullim duhet të bëhet mbi bazat e ndryshimeve të së drejtës së zbritjes për vitet pasuese në lidhje me TVSH-në e zbritshme që është zbritur në lidhje me mallrat kapitale. Nuk do të bëhet asnjë rregullim në zbritjen e TVSH-së së zbritshme nëse diferenca në proporcionin aktual të zbritshëm, koeficienti i kreditimit tatimor, është më pak se sa tre përqind (3%) të vlerës së TVSH-së së zbritshme. 4. Nëse këto furnizohen gjatë periudhës së rregullimit,*

mallrat kapitale duhet të trajtohen sikur të jenë aplikuar në një aktivitet ekonomik të personit të tatueshëm derisa të përfundon periudha rregulluese. Aktiviteti ekonomik duhet të supozohet se është plotësisht i tatueshëm në rastet kur furnizimi i mallrave kapitale është i tatuar. Aktiviteti ekonomik duhet të supozohet se është plotësisht i liruar në rastet kur furnizimi i mallrave është i liruar. Rregullimi që parashihet në paragrafin 4 të këtij neni do të bëhet vetëm njëherë lidhur me gjithë periudhën e mbuluar nga periudha korrigjuese që mbetet për t'u shfrytëzuar.5. Ministri i Financave nxjerr akt nënligjor për të regjistruar rregullimet e TVSH-së dhe për të përcaktuar TVSH-në e zbritshme dhe të pa-zbritshme në lidhje me këto rregullime. Neni 61paragrafi 1 Rregullat dhe procedurat për daljet jashtë përdorimit të mallrave Udhëzimi Administrativ 03/2015 nënparagrafi 1.2.*Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për arsye të sigurimit të mallit, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse. 1.3. Barra e provës i takon personit të tatueshëm, i cili duhet gjithashtu të zbatojë procedurat përkatëse sipas Ligjit, si dhe procedurat e parapara në legjislacionin e sektorit ku operon.* 3.Raste të tjera të dëmeve apo shkatërrimit të pasurisë 3.1. *Shkatërrimi i pasurisë së personit të tatueshëm për shkaqe natyrore të tilla si tërmete, përmbytje, djegie, etj., në raste emergjencash civile sipas legjislacionit të fushës, ose për shkak të aksidenteve, të cilat janë të verifikueshme dhe të*
dokumentuara nga institucioni public përkatës, nuk është objekt i rregullimit të TVSH-së së zbritur. 3.2.*Kur mallrat janë dëmtuar apo shkatërruar nga fatkeqësia nuk kryhet rregullimi i TVSH-së së zbritshme që lidhet me mallrat e dëmtuara, të shkatërruara nëse personi i tatueshëm dokumenton: 3.2.1.Një përshkrim të mallrave të dëmtuara, shkatërruara përfshirë numrin e njësive/ sasinë e secilit lloj të mallit; 3.2.2.Dokumente ose një evidencë të blerjes së mallrave dhe çmimin me të cilin mallrat janë blerë; 3.2.3.Raportin përkatës nga organi*
kompetent që vërteton se mallrat janë dëmtuar, shkatërruar, si dhe mënyrën (ngjarjen) me të cilën mallrat janë dëmtuar apo shkatërruar; 3.2.4. Datën në të cilën mallrat janë dëmtuar, shkatërruar; 3.3.Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme sipas këtij neni personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin ose për arsye të sigurimit të mallit, ose vlerë të rikuperueshme për mallin e dëmtuar, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në këtë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse. Neni 6 paragrafi 1 të ardhurat e tatueshme-Ligji nr.06/L-105 "*1. Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme është ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuara ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij ligji*". Neni 24 humbjet tatimore Ligji nr.06/L-105. 1. *Humbja tatimore është ndryshimi negativ ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të lejuara të përcaktuara me këtë ligj. 2. Shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, bartet deri në katër (4) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite. 3. Shuma e bartur që merret parasysh për çfarëdo periudhe tatimore pas vitit të humbjes tatimore, është shuma e përgjithshme e humbjes e zvogëluar për shumën e grumbulluar që është lejuar më parë si zbritje. 4. Nëse tatimpaguesi ka pasur humbje tatimore më gjatë se një (1) vit, ky nen zbatohet për humbjet që janë krijuar sipas radhës.* ***Konkluzioni/Përfundimi*** Bazuar në sqarimet ligjore të dhëna më sipër, për aq sa keni ofruar informata dhe për aq sa është kuptuar kërkesa rrjedh se: 1. Nëse mallrat për të cilat nuk

zbatohet rregulli i TVSH-së së zbritshme, personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin ose për arsye të sigurimit të mallit, ose vlerë të rikuperueshme për mallin e dëmtuar, atëherë për vlerën e përfituar minus TVSH përkatëse. 2.Po ashtu sipas legjislacionit tatimor aktualisht të zbatueshëm kjo rregull vlen edhe për mallrat kapitale. Nëse mallrat për të cilat nuk zbatohet rregulli i TVSH-së së zbritshme menjëherë pas largimit nga përdorimi të aseteve kapitale, atëherë nëse personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogaritë TVSH. Vlera e tatueshme në ketë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse. 3.Dhe po ashtu sipas legjislacionit tatimor aktualisht të zbatueshëm kjo rregull vlen edhe për ndërtesën e dëmtuar. Nëse muk zbatohet rregullimi i TVSH-së së zbritshme menjëherë pas largimit nga përdorimi të ndërtesës, atëherë nëse personi i tatueshëm përfiton dëmshpërblim për dëmin ose vlerën e rikuperueshme, atëherë për vlerën e përfituar, personi i tatueshëm llogarit TVSH. Vlera e tatueshme në ketë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse. Në rast të kompensimit të dëmit nga Kompania e Sigurimeve, të hyrat e tilla konsiderohen të ardhura të tatueshme për qëllime të Tatimit në të Ardhura të Korporatave, në vitin fiskal kur ato pranohen. 4.Sa i përket humbjes tatimore, konstatimi juaj është i saktë, shpenzimi i zbritshëm në raste të tilla korespodon me humbjen neto d.m.th. vlerën totale të dëmit minus çdo kompenzim sigurimi të marrë (duke pas parasyshë që nga shuma e kompenzimit fillimisht të zbritet TVSH-ja përkatëse nëse nuk janë bërë rregullimet para përfitimit të dëmshpërblimit). Andaj nga sa u tha me lartë, rrjedhë se shuma e kompensimit të bërë nga kompania e sigurimit për “......, konsiderohet e hyrë për qellime tatimore, si për Tatimin në të Ardhura të Korporatave ashtu edhe për TVSH. Vlera e tatueshme në ketë rast është vlera e përfituar minus TVSH përkatëse, e cila përcaktohet duke llogaritur nga shuma e kompensimit në bazë të koeficientit të TVSH-së për normen standarde. Kjo përgjigje është e bazuar vetëm në informatat e ofruara në kërkesën e parashtruar. Çdo konstatim tjetër i informatave nga zyrtarët tatimor/kontrolli, do te trajtohet sipas nenit 15 të Ligjit Nr.08/L-257 Për Administratën e Procedurave Tatimore.

Administrata Tatimore -Njësia e Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave në lëndë, pretendimeve në ankesë konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është e pa lejueshme

Dispozitivi i këtij vendimi të Divizionit të Ankesave mbështetet mbi faktet në vijim:
Me datë 20.11.2025 me nr. protokolli protokolli. ...../25 kemi pranuar ankesën e tatimpaguesit “..... me NUI: ....., tatimpaguesi me datë ..... me nr. protokolli ..../2025 ka parashtruar kërkesë për konfirmim të trajtimit të TVSH-së dhe Tatimit në të Ardhura të Korporatave për mallrat dhe asetet e dëmtuara nga zjarri aksidental. Si përgjigje ndaj kësaj kërkese, Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesve në DTM ka lëshuar dokumentin me nr. protokolli ...../2025 datë .....2025 dhe nr. reference E-..... 2025 i cili sipas përmbajtjes dhe bazës ligjore paraqet këshillë/sqarim/përgjigjeje, me natyrë informuese dhe orientuese. Ky dokument nuk paraqet përcaktim zyrtar tatimor, në kuptim të Ligjit Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, rrjedhimisht nuk prodhon efekt juridik detyrues, si dhe nuk krijon apo ndryshon detyrime tatimore për tatimpaguesin dhe se këshilla/sqarim/përgjigjeje profesionale nuk është objekt i ankesës administrative. Pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore të paraqitura nga tatimpaguesi, dhe analizimit te

provave te dorëzuara, si dhe këshillës/sqarimit/përgjigjes pas marrjes parasysh të informatave shtesë nuk paraqet vendim shpjegues individual sepse qëllimi i tij është një përgjigje profesionale sipas kërkesës se ankuesit/tatimpaguesit. Edhe po te ishte një Vendim Shpjegues Individual nuk do të konsiderohet të jetë një përcaktim i Drejtorit të Përgjithshëm që i nënshtrohet procedurave të Ligjit për ankesa. Nëse pranuesi i vendimit shpjegues pajtohet me aplikimin e ligjit për shkak të një keqkuptimi të fakteve apo rrethanave, mund të dorëzojë një kërkesë për ri përfillje përmes një letre tek Drejtori i Përgjithshëm duke specifikuar faktet apo rrethanat që nuk janë kuptuar dhe ndikimin e atij keqkuptimi në vendimin shpjegues të lëshuar. Letra e tillë duhet të dorëzohet brenda 30 dite pas datës kur është lëshuar vendimi shpjegues. Çdo kërkesë e dorëzuar pas 30 ditëve nga data e lëshimit të vendimit shpjegues do të konsiderohet të jetë kërkesë e re për vendim shpjegues. Pas marrjes parasysh të informatave shtesë, Drejtori i Përgjithshëm mund të informojë kërkuesin me shkrim se vendimi shpjegues mbetet i pandryshuar, apo Drejtori i Përgjithshëm mund të lëshojë një vendim shpjegues të ndryshuar i cili zëvendëson vendimin e parë shpjegues. Pritet që Drejtori i Përgjithshëm, apo i deleguari i tij, do të jetë në komunikim të rregullt me personin që ka kërkuar vendim shpjegues individual me qëllim të minimizimit të ndonjë keqkuptimi. Për këto arsye, Divizioni i Ankesave vlerëson se ankesa e paraqitur është e pabazuar dhe si e tillë refuzohet. Nëse i referohemi Nenit 57 te Ligjit 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore ne mënyre te çartë thekson "*Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Njësisë së Ankesave, e cila ka përgjegjësi të vlerësojë kërkesat për rishqyrtim nga personat të cilët kundërshtojnë një vlerësim ose vendim të ATK sipas legjislacionit të administruar nga ATK, si instancë e parë ankimore në procedurën administrative*", duke nënkuptuar se Divizioni i ankesave, shqyrton vetëm vendimet dhe vlerësimet por jo edhe këshillat profesionale si ne rastin konkret. Ndërsa Neni 111 par. i këtij Ligji detajon edhe me tepër ketë çështje duke theksuar "*Një person i cili kundërshton vlerësimin e tatimeve ose përcaktimin zyrtar të ATK, mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim në Njësinë e Ankesave për të ri-shqyrtuar përcaktimin zyrtar. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin e vlerësimit ose përcaktimin tjetër zyrtar. Kërkesa duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përmbajë arsyet dhe dokumentet mbi të cilat tatimpaguesi e bazon kërkesën*", pra ne mënyre te çartë thekson se kundërshtimi/ankesa për rishqyrtim mund te behet vetëm ndaj vlerësimeve te tatimit/ njoftim rivlerësimit ose përcaktimit zyrtar te ATK-se. Kjo çështje parashihet edhe ne Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht ne Nenin 126 par. 1 i cili thekson "*Ankesa duhet të përcaktojë aktin apo heshtjen administrative që ankimohet, shkaqet dhe arsyen pse ankimohet dhe organin publik kompetent për aktin*". Andaj duke pasur parasysh qe ankesa është e drejtuar ndaj këshillës/sqarimit/përgjigjes profesionale me nr. reference E..... 2025 me nr. protokolli ...../2025 datë .....2025 nuk përben përcaktim zyrtar dhe ndaj tij nuk është e lejuar ankesa ne Divizionin e Ankesave.

Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh kontestin dhe të gjitha provat të cilat gjendën në shkresat e lëndës, në përputhje me Nenin 132, pika (2), të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L- 031, Njësia e Ankesave e vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 111 të Ligjit Nr. 08/L-257 "Për Administrimin e Procedurave Tatimore ", tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejt që brenda afatit (30) ditësh , nga dita e pranimit të Vendimit të Njësisë së Ankesave ,ta kundërshtojë këtë Vendim tek Bordi i Ankesave pranë Arkivës se Ministrisë së Financave ,Punës dhe Transfereve që gjendet në objektin e Qeverisë së Republikës së Kosovës , në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë apo edhe në formë elektronike ne adresën :bordi.ankesa@rks-gov.net.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. ../25 datë 2025

Vendimi t'iu dorëzohet:
1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Ud. Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Arbnor Avdyli_____

Kryesuese e panelit
Vlora Rrustaj _____